Në Republikën e Maqedonisë, sikurse edhe në disa vende të tjera evropiane, nga e kaluara dhe deri më sot, vërehet dukuria e diskriminimit të tërthortë të fëmijëve romë, përmes të ashtuquajturit segregacion në shkolla të posaçme (më herët përdorej nocióni speciale), përkatësisht paralele në rast se fëmija mëson në shkolla të rregullta. Segregacioni, përkatësisht ndarja e këtyre fëmijëve bëhet përmes kategorizimit të tyre si persona me aftësi të kufizuara në zhvillimin psikik. Ky kategorizim, në procesin e përgjithshëm arsimor të fëmijës e vë atë në pozitë inferiore, në raport me fëmijët e tjerë të cilët nuk janë kategorizuar, meqë nuk ka mundësi të arsimohet sipas programeve të njëjtë mësimore dhe lëndore, nuk ka mundësi të arsimohet në një mjeshtësi fëmijë të cilët nuk kanë pengesa në zhvillimin psikofizik dhe ka mundësi të vogla që ta vazhdojë arsimin e mesëm sipas dëshirave personale. Nga ana tjetër, fëmija i kategorizuar në këtë mënyrë i cili arsimohet në arsimin fillor në një mjeshtësi të segreguar e vazhdon procesin mësimor në ato shkolla të mesme profesionale të cilat ofrojnë arsim përfëmijë me aftësi të kufizuara. Në mënyrë plotësuese, ky diskriminim i tërthortë do të kualifikohet edhe si *i vazhdueshëm* meqë nuk përqendrohet vetëm në procesin arsimor por ka ndikim edhe mbi zhvillimin e mëtutjeshëm të personalitetit i cili është kategorizuar në mënyrë të pabazë dhe në bazë të aspekteve shoqërore, ekonomike dhe familjare të jetës të personit në fjalë.

Me fjalë të tjera, mospasja e mundësive që të fitohet arsimim përkatës përfëmijët pa pengesa në zhvillim, krijon probleme plotësuese në procesin e gjetjes së punës dhe avancimit në procesin e punës. Për shkak të kualifikimit të reduktuar dhe të kufizuari, këta persona nuk janë konkurrent në tregun e punës dhe janë pak të paguar, në të shumtën e rasteve nuk kanë mundësi të vazhdojnë me arsimin e mëtutjeshëm, nuk kanë mundësi të fitojnë pozita më të larta në organizatën e punës dhe shpeshherë ekziston reziku përfërjashtimin nga puna, pikërisht përfshak të kategorizimit të tyre. E gjithë kjo, pastaj ndikon nëmargjinalizimin e këtyre personave si qytetarë të moshës madhore, i cili ka filluar që në procesin e arsimit. Krijimi i perceptimit se ata kanë pengesa në zhvillimin psikik krijon stigmatizim ndaj tyre nga ana e komunitetit dhe përfërjashtim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aspektet e ndryshme të shoqërisë. Problemi multiplikohet meqë shumë shpesh këta persona e pranojnë këtë status si normal dhe inferioritetin si dukuri natyrore. Shumë shpesh, fëmijët e personave të cilët janë kategorizuar dhe kanë mësuar në shkolla të posaçme, përkatësisht paralele të posaçme bëhen nxënës me kategorizim.

Këtë dukuri mund ta karakterizojmë si sistematike meqë diskriminimin nuk e bën vetëm ndonjë individ dhe as vetëm ndonjë institucion por kemi një sistem (lidhja e elementeve në një tërsi) të institucioneve, personave përgjegjës dhe të punësuar në procesin gjithëpërfshirës të kategorizimit dhe vazhdim të mëtutjeshëm të kësaj dukurie pa ripërkufizimin, rishikimin, përkatësisht rikategorizimin. Në përpjekje me përvojat e vendeve të ndryshme është dëshmuar se diskriminimi sistematik është afatgjatë, përkatësisht përsëritje shumëvjeçare të ndonjë dukurie, e pranueshme përfshirëtinë, e shfrytëzuar në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme nga personat të cilët bëjnë

diskriminim. Përveç dukurisë së formës së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shpeshherë duke rezultuar me diskriminimsipas asocacionit të shoqëruar edhe me formën e instruksionit përfshirë, kinse norma neutrale, por shpeshherë pamjaftueshëm të përkufizuar dhe autorizime të diskrecionit që ua kanë kaluar personave zyrtarë.

## 1. KORNIZA METODOLOGJIKE E HULUMTIMIT

Hipoteza kryesore e hulumtimit konsiston me:

*Në Republikën e Maqedonisë, në nivel nacional dhe në nivel të disa komunave, përqindja e fëmijëve romë të cilët janë kategorizuar si persona me pengesa në zhvillimin psikik është në masë të konsiderueshme më i madh në krahasim me përqindjen e numrit të përgjithshëm të fëmijëve romë në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve, pjesëtarë të të gjitha bashkësive etnike. Kjo dukuri është si rezultat i një sërë faktorësh kulturor, mungesës së kapacitetit institucional dhe bashkëpunimit ndër-institucional, zbrazëtirave, mospërputhjes dhe jokonsekuencësprocedurale dhe juridike dhe mospasjestë mjaftueshme të vetëdijes tek prindërit dhe tek personat zyrtarë.*

*Dukuria e diskriminimit të tërthortë përmes segregacionit është sistematike, afatgjatë dhe e rrënjosur në shoqëri. Së këtejmi, nevojitet një qasje sistemore, institucionale dhe e organizuar në drejtim të reduktimit të kësaj dukurie.*

Hulumtimi u zbatua në periudhën kohore nga muaji prill të vitit 2014 deri në nëntor të vitit 2014 përmes përdorimit të këtyre teknikave të grumbullimit të të dhënave:

- Anketë, e cila u realizua përmes pyetësorëve të dërguar me postë deri te të gjitha komunat brenda shtetit. Një pjesë më e madhe e komunave, Pyetësorin ua shpérndanë drejtoreve të shkollave filllore të cilat veprojnë në kuadër të juridikzionit të tyre, pastaj i dërguan rezultatet e sublimuara, ndërsa pyetësorët e plotësuar nga shkollat u dërguan në përpunim deri te Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i komunave vetëm i kanë shpérndarë pyetësorët deri te shkollat filllore, ndërsa pastaj drejtoret në mënyrë të drejtpërdrejtë i dërguan pyetësor për përpunim, pa e ndërmarrë këtë obligim komuna. Për këtë shkak, disa të dhëna nga komunat nuk janë të plota, përkatësisht mungojnë të dhëna nga ndonjë shkollë në kuadër të disa komunave. Megjithatë, edhe pse pyetësorët iu dërguan të gjitha komunave, të dhëna u pranuan nga 57 komuna, ndërsa prej shtatë komunave (Krivogashtan, Dollnen, DemirHisar, Bërvencë, Demir Kapi, Haraçinë dhe Çeshinovë-Obleshevë) është pranuar përgjigje se nuk kanë fëmijë të kategorizuar, që paraqet një shembull përkatës dhe relevant që të fitohet statistikë relevante dhe të miratohen konkluzione përkatëse.
- Në pyetësorët e dedikuar për shkollat e rregullta filllore kërkoheshin të dhëna se sa nxënës të kategorizuar në total mësojnë në paralelet e rregullta dhe të posaçme nga viti 2010 deri në vitin 2014 për çdo vit veç e veç dhe sa nxënës janë regjistruar në çdo vit veç e veç.

- Në mënyrë plotësuese, Pyetësori u dërgua edhe deri te të gjitha shkollat e posaçme. Në pyetësorin e dedikuar për shkollat e posaçme kërkoheshin informata të njëjtë, me atë dallim që në këto shkolla nuk ka paralele të rregullta (për fëmijë pa pengesa në zhvillim). Në të dy pyetësorët u kërkua që të dhënat të strukturohen sipas përkatësisë etnike të fëmijës.
- Nga shkolla e posaçme filllore "Idnina" nuk u pranuan të dhëna.
- U realizuan dy fokus grupe. Fokus grupi i parë, që u mbajt më 3 korrik të vitit 2014, kishte për qëllim që t'i identifikojë shkaqet e dukurisë dhe tendencat e ndryshimeve të fenomenit të shkallës së lartë të fëmijëve të kategorizuar romë. Në të morën pjesë përfaqësues nga shërbimet profesionale të disa shkollave të posaçme, shkolla filllore në Shuto Orizarë, përfaqësuesi i Komisionit pranë Entit për Shëndet Mendor, profesorë nga Instituti për Defektologji pranë Fakultetit Filozofik në Shkup, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues të organizatave civile dhe të organizatave ndërkombëtare të cilat punojnë në këtë problematikë. Brenda fokus grupit u diskutuan disa tema, si vijojnë: Procedura e kategorizimit, si kufizohet shpërfillja e arsimimit nga pengesat në zhvillimin psikik, cilat janë dobësítë institucionale dhe kadrovike, cilat janë dobësítë në bashkëpunimin ndër-institucional, cilat janë tendencat (pozitive dhe negative) në ndryshimin e gjendjes dhe ngashëm. Në fokus grupin e dytë, i cili u mbajt më 13 nëntor të vitit 2014, morën pjesë përfaqësues nga institucionet si në fokus grupin e parë, ndërsa u diskutuan masat që janë ndërmarrë dhe që do të ndërmerren nga ana e institucioneve në drejtim të tejkalimit të problemit, u diskutuan draft-rekomandimet të cilat rezultuan nga informatat e fituara përmes hulumtimit të zbatuar, si dhe u zhvillua një diskutim mjaft i gjallë për draft-modelin për vlerësim (draft-version i përpiluar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, tetor 2014). Informatat, nga të dy fokus grupet, janë instaluar në këtë Raport hulumtues në mënyrë që ishin ose bazë për plotësimin e të dhënave që i përmbanin dokumentet zyrtare ose udhëzim për sigurimin e informatave plotësuese përmes zhvillimit të intervistës ose grumbullimit të të dhënave plotësuese. Disa prej deklaratave të pjesëmarrësve janë inkorporuar si parafrazë ndërsa disa të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë, megjithatë për shkak të diskrecionit të burimit të informatës theksohet institucioni apo sugjerohet se është qëndrim i pedagogut, psikologut, mësimdhënësit ose drejtorit të shkollës ose se është qëndrim i përfaqësuesit të organit administrativ ose i sektorit civil. Bloqet tematike, për të cilat u zhvilluan diskutime në fokus grupet, u përgatitën në bazë të një analize paraprake primare të gjendjes përmes grumbullimit të burimeve sekondare të të dhënave (analiza paraprake, dokumente zyrtare dhe statistikë) dhe intervista të realizuara përgatitore.

- Për shkak të identifikimit më të thellë të problemit dhe sigurimit të qëndrimeve relevante për tejkalimin e tij në të ardhmen, u realizuan gjithsej trembëdhjetë intervista me: përfaqësuesin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, me dy pediatër, me tre psikologë nga shkollat fillore, tre pedagogë nga shkollat fillore, një defektolog nga një shkollë e posaçme dhe një i punësuar në organizatë civile, aktiviteti i së cilës është mbrojtja e të drejtave të romëve.

## 2. TREGUES KUANTITATIV TË SEGREGACIONIT TË FËMIJËVE ROMË NË PERIUDHËN KOHORE 2010-2014

Duhet të theksohet se në analizë nuk janë përfshirë ato komuna në të cilat në asnjë vit nuk ka asnjë fëmijë të kategorizuar, pjesëtarë të bashkësisë etnike rome. **Theksojmë se është bërë një model strukturor, përkatësisht komuna në juridiksonin e të cilave është evidentuar fëmijë pjesëtar i bashkësisë etnike rome. Përqindja e përgjithshme e segregacionit nuk e pasqyron gjendjen në nivel shtetëror meqë nuk janë përpunuar ato komuna të cilat nuk e kanë plotësuar Pyetësorin (i plotësuar nga 57 komuna) dhe ato komuna në të cilat nuk ka fëmijë të kategorizuar që i takon bashkësisë rome.** Një model i këtillë i strukturuar është bërë meqë grupohen në një vend komunat në të cilat supozohet se jetojnë fëmijë romë (e që së paku një fëmijë, gjatë pesë viteve të fundit, është kategorizuar), nuk përfshihen komunat e tjera veçanërisht nëse janë të mëdha të cilat nuk kanë bashkësi rome. Meqë përfshirja e tyre mund të ketë ndikim të lartë statistikor mbi konkluzionet kuantitative dhe për shkak të pasqyrës statistikore, përkatësisht në grafikët në mënyrë të panevojshme të pasqyrohen komunat në të cilat jepen të dhëna të cilat nuk janë relevante për objektin e hulumtimit. Meqë, arsimi është i decentralizuar, rekomandohet që interpretimet të udhëzohen më shumë në drejtim të nivelit komunal, përkatësisht problemi i segregacionit të perceptohet më shumë në mënyrë segmentare, nga komuna në komunë dhe pastaj të nxirret konkluzion kumulativ, sesa të interpretohet në mënyrë statistikore në nivel nacional.

Sipas të dhënave të siguruara, në vazhdim janë pasqyruar rezultatet për ato komuna në të cilat vërehet përqindja më e lartë e fëmijëve të kategorizuar romë. Në vitin shkollor 2010/2011 përqindje më të lartë të fëmijëve të kategorizuar romë në paralele të rregullta ka në Vinicë - 63%, ndërsa në paralele të posaçme në Shtip - 77,78%. Tendenca e njëjtë është vërejtur edhe në vitin shkollor 2011/2012. Në Vinicë kjo përqindje është më e lartë kur bëhet fjalë për paralelet e rregullta - 65%, ndërsa në Shtip sa u përket paraleleve të posaçme - 78,38%.

Në vitin shkollor 2012/2013, Shtipi është në krye të listës sa u përket paraleleve të rregullta - 35,29%, ndërsa Prilepi sa u përket paraleleve të posaçme - 66%. Në vitin shkollor 2013/2014, sa u përket paraleleve të rregullta përqindje më e lartë të fëmijëve të kategorizuar romë në paralelet e rregullta ka në Dellçevë - 55,55%, ndërsa sa u përket paraleleve të posaçme në krye të listës është Prilepi - 63%.

Nëse viti shkollor 2010/2011 merret si vit fillestar, ndërsa viti 2013/2014 si vit përfundimtar, në përgjithësi nuk mund të vërehet një tendencë e konsiderueshme e reduktimit të numrit të fëmijëve të kategorizuar romë në paralelet e rregullta. Në Shtip, ku kjo përqindje është e lartë, nuk vërehet reduktim, - 33% në Dibër, - 63% në Vinicë. Tek paralelet e posaçme këto ndryshime janë më të dukshme dhe kjo është një e dhënë pozitive meqë qëllimi është tendanca e reduktimit të jetë më e lartë tek paralelet e posaçme,


në kahasim me paralelet e rregullta në të cilat mësojnë fëmijët e kategorizuar.

Edhe pse ka tendencë të reduktimit, megjithatë kjo tendencë nuk është e madhe, nëse merret parasysh se bëhet fjalë për një periudhë katërvjeçare. Në Shtip përqindja reduktohet për 16%, në Kumanovë për 32%, në Manastir për 9%, në Vinicë për 11%, stagnim vërehet në Dellçevë, Tetovë, Strugë, Kavadar dhe Prilep (dy komunat e fundit mbeten me përqindje të lartë mbi 50%). Tendencë e rritjes vërehet në Koçan për 4%, KisellaVodë për 43%, Kërçovë për 11%.

**Tabela 1**

Komuna	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të rregullta në vitin 2010/2011	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në vitin 2011/2012	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në vitin 2012/2013	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të rregullta në vitin 2013/2014
Shtip	35,29	42,86	35,29	35,29
Kumanovë	14,85	23,85	16,13	14,89
Çair	20,00	18,18	10	16,67
Tearcë	14,29	23,08	0	22,22
Gostivar	0,00	0	0	0
Dibër	33,33	33,33	0	0
Vinicë	63,16	65	0	0
Aerodrom	8,70	6	0	7,5
Gazi Babë	5,45	0	10,13	10
Gjorçe Petrov	10,00	11,76	0	4,17
Koçan	0,00	0	100	100
Veles	0,00	0	0	0
Kisella Vodë	4,08	0	7,27	4,17
Dellçevë	0,00	0	0	55,56
Tetovë	13,16	14,63	20	13,85
Strugë	0,00	0,00	0	0
Kavadar	9,09	9,09	9,09	9,09


Rankovc	50,00	50,00	50	50
Prilep	7,14	10,71	12,28	3,03
Kërçovë	0	0	0	12,5
Kriva Pallankë	0	11,11	0	18,18
Rosoman	0	20	50	50

**Grafiku 1**

Në Tabelën 2 pasqyrohet përqindja e romëve me pengesa në zhvillimin psikik sipas komunave. Përqindja është përllogaritur sa i përket numrit të përgjithshëm të fëmijëve me pengesa në zhvillimin psikik, sipas komunave veç e veç, të cilët mësojnë në lloj të caktuar të paraleles. Është bërë një kahasim me vite të ndryshme shkollore të romëve me pengesa në zhvillimin psikik të regjistruar në paralele të posaçme sipas komunave.

**Tabela 2**


Komuna	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2010/2011	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2011/2012	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2012/2013	Nxënës romë, të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, të cilët kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2013/2014
Shtip	77,78	78,38	60	61,29
Kumanovë	71,21	55,17	48	39,58
Tearcë	0	0	12,5	0
Gostivar	25	25	17,65	0
Venicë	11	12,5	0	0
Gazi Babë	0	0	7,69	0
Koçan	31,82	26,67	41,18	35,71
Kisella Vodë	7,14	7,14	61,54	50
Dellçevë	60	47,06	53,33	56,25
Tetovë	15,15	15,15	0	16,67
Strugë	10	9,09	11,11	9,09
Kavadar	57,89	52,94	59,09	56,52
Prilep	60,78	66,07	66,04	63,04
Kërçovë	0	12,5	12,5	12,5
Manastir	51,61	37,5	38,24	42,42

**Grafiku 2**

Nëse merren parasysh vetëm ato komuna në të cilat në cilido qoftë vit shkollor, nga vitit 2010/2011 deri në vitin 2013/2014 është evidentuar së paku një fëmijë i kategorizuar nga bashkësia etnike rome, totali i përqindjes së reduktimit të këtyre fëmijëve të kategorizuar në paralele të rregullta është shumë i butë, në lartësi prej 1,2%, ndërsa në paralelet e posaçme ky reduktim në vitin shkollor 2013/2014 në raport me vitin shkollor 2010/2011 është 5%, e që është pasqyruar qartë në Tabelën 3 dhe Grafikun 3.

**Tabela 3**

	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Përqindja e nxënësve romë-të kategorizuar si fëmijë me nevoja të veçanta në paralele të rregullta, në nivel të shtetit	8,6675	9,886	8,857	7,632
Përqindja e nxënësve romë-të kategorizuar si fëmijë me nevoja të veçanta në paralele të posaçme, në nivel të shtetit	44	41,43	41,315	39,012

**Grafiku 3**


Nëse si numër i përgjithshëm për analizë merren vetëm ato komuna në të cilat në cilindro qoftë vit shkollor nga viti 2010 deri në vitin 2014 është regjistruar së paku një fëmijë që i takon bashkësisë etnike rome, do të vërehet se regjistrimi i fëmijëve romë të kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik në vitin 2014, në raport me vitin 2010, ka shënuar rritje për 20%, ndërsa për po aq përqindje është reduktuar numri i fëmijëve romë, të cilët janë regjistruar në klasë të parë në paralele të posaçme në vitin 2014 në raport me vitin 2010.





Kjo paraqet një tendencë pozitive duke e pasur parasysh atë se rekondim i përgjithshëm është të rritet numri i fëmijëve me kategorizim në paralelet e rregullta, duke e respektuar në këtë mënyrë procesin e inkluzionit. Megjithatë, shqetëson fakti që përqindja e fëmijëve romë prapë se prapë është e lartë, të cilët regjistrohen në paralele të rregullta meqë janë të kategorizuar, ndërsa kjo e nënkupton të ashtuquajturin segregacion latent ose semisegregacionin në kuadër të paraleles (për këtë shihni më poshtë në pjesën që ka të bëjë me shkaqet e segregacionit).





**Tabela 4**

	2010	2011	2012	2013	2014
Nxënës romë të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik janë regjistruar në klasë të parë, në shkolla të rregullta në paralele të rregullta	25	54,17	51,52	40	45,45
Nxënës romë të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik janë regjistruar në klasë të parë, në shkolla të rregullta në paralele të posaçme	75	45,83	48,48	60	54,55

Në vazhdim janë pasqyruar frekuencat në shifra absolute për numrin e përgjithshëm të fëmijëve të kategorizuar, nga njëra anë dhe nga ana tjeter numrin e fëmijëve romë, për çdo pyetje veç e veç, të cilën e përban Pyetësori që u është dërguar komunave dhe që është dhënë si aneks i këtij Raporti (Aneksi 1). Diagramet e pasqyrojnë proporcionin e përgjithshëm përkundrejt fëmijëve romë, jo në përqindje por me numrën të fëmijëve të regjistruar që të tejkalohet problemi statistikor i cili paraqitet me numra të vegjël të cilët, në nivelin e numrit të vogël të fëmijëve në përgjithësi të regjistruar me kategorizim mund të paraqes përqindje të lartë. Diagramet e pasqyrojnë tendencën sipas komunave, ndërsa pasqyrimi i tyre ndihmon që të detektohet se sa është pjesëmarrja e fëmijëve romë në numrin e përgjithshëm sipas komunave, si dhe të krahasohet tendenca për çdo pyetje midis komunave. Edhe këtu janë pasqyruar vetëm ato komuna në të cilat së paku në njërin nga katër vitet e analizuar është regjistruar fëmijë në paralele të rregullt ose të posaçme i cili është kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik dhe është pjesëtar i bashkësisë rome.


**Grafiku 4**

**Grafiku 5****Grafiku 7****Grafiku 6****Grafiku 8**


**Grafiku 9****Grafiku 11****Grafiku 10****Grafiku 12**

**Grafiku 13**


Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, janë regjistruar në klasë të parë, në shkolla të rregullta në paralele të rregullta në vitin 2012

**Grafiku 15**


Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, janë regjistruar në klasë të parë në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2012





**Grafiku 14**


Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të posaçme në vitin 2012-2013

**Grafiku 16**

Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik, kanë mësuar në shkolla të rregullta në paralele të rregullta në vitin 2013-2014



**Grafiku 17****Grafiku 19****Grafiku 18****Grafiku 20**

**Grafiku 21**

Mund të vërehet re se numri i fëmijëve, të cilët regjistrohen në klasë të parë në paralele të rregullta ose të posaçme, ndërkaq i takojnë bashkësisë etnike rome, nuk është edhe aq i madh aq sa rritet numri në nivel të përgjithshëm në vitin shkollor ose nga ana tjetër të kontribuojë për rënien aq të vogël në vite të caktuara. Kjo mund të paraqes rezultat të disa faktorëve, por më e besueshme është se është rezultat edhe i kategorizimit të fëmijëve gjatë klasave më të larta, transferimi i fëmijëve nga paralelet e posaçme në ato të rregullta ose nga ana tjetër fakti që më herët ky numër ka qenë shumë më i madh dhe ata fëmijë tanimë janë nxënës në klasat më të larta.

Deri te drejtoret e të gjitha shkollave të posaçme u dërguan pyetësor, megjithatë nuk u plotësuan nga të gjithë, përkatësisht nuk kemi të dhëna nga të gjitha shkollat e posaçme filllore. Për këtë shkak, në këtë Raport janë pasqyruar të dhëna vetëm nga ato shkolla të posaçme filllore prej të cilave janë pranuar përgjigjet.

Në SHPF "Kliment Ohridski" numri i fëmijëve romë është shumë i vogël (Tabela 5).

**Tabela 5**

NovoSellië (SHPF "Kliment Ohridski")	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Sa gjithsej nxënës romë, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	0	1	1	2
Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	52	50	48	50


Në shkollën "DrZllatan Stremac" situata është ndryshe. Në këtë shkollë në vazhdimësi kemi përqindje të lartë të fëmijëve romë, megjithatë gjëzon fakti që në vitin shkollor 2013/2014, ky numër është tre herë më i vogël në krahasim me vitin 2010/2011 (Tabela 6).

**Tabela 6**

Shkup ("Dr. Zllatan Sremec")	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	161	153	126	123
Sa gjithsej nxënës romë, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	64	40	22	22

**Grafiku 22**


Tendenca e reduktimit të numrit të fëmijëve të regjistruar në klasë të parë është më i vogël dhe ka tendencë të reduktimit, megjithatë supozohet se në klasat më të larta transferohen fëmijë në këtë shkollë të posaçme filllore.

**Grafiku 23**

Megjithatë, tendencë e segregacionit është e pranishme edhe në shkollat e rregullta në Shtip, ashtu sikurse edhe në Shkollën e Mesme "Iskra" në këtë qytet. Ndoshta kjo është e dhe e kuptueshme meqë këtu regjistrohen fëmijë të cilët arsimin fillor e kanë kryer si fëmijë të kategorizuar, megjithatë shqetëson fakti i rritjes së përqindjes.

**Tabela 7**

Shtip (SHMSH "Iskra")	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Sa nxënës në total, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	89	91	89	87
Sa nxënës gjithsej romë, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë	27	36	39	38

**Grafiku 24****Tabela 8**

Shtip (SHMSH "Iskra")	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
Sa nxënës gjithsej romë, të cilët janë kategorizuar si fëmijë me pengesa në zhvillimin psikik kanë mësuar në shkollë (në përqindje)	30,34	39,56	43,82	43,68

**Grafiku 25**

### 3. SHKAQET E EKZISTIMIT TË PROBLEMIT

#### 3.1. KONTEKSTI SHOQËROR - KULTUROR

Objekt i këtij hulumtimi nuk ishin faktorët shoqëror-kulturor të cilët ndikojnë mbi segregacionin e fëmijëve romë. Ky faktor, sikurse edhe shumë të tjerë, nuk mund të përdoret si justifikim për ekzistimin e kësaj dukurie. Për këtë shkak, vetëm sqarohen shkurt faktorët të cilët ndikojnë në fenomenin e diskriminimit të tërthortë, pa u përdorur metodat sociologjike dhe antropologjike dhe rrjedhimisht me këtë analizat, duke e marrë çdoherë parasysh se objekt i hulumtimit është diskriminimi, ndërsa faktorët e tjerë shihen si kontekst të dukurisë.

Nga intervista e realizuar në fokus grupet, si dhe në bazë të hulumtimeve paraprake, mund të konstatohet se vet-perceptimi për pjesëmarrje të grupit i cili tradicionalisht është në pozitë inferiore të cilët nuk i nevojitet arsimi, si dhe perceptimi i pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike se romët kanë "stil të tyre të jetës", "nuk duan të mësojnë dhe nuk ju duhet arsimi" dhe njashëm, janë paragjykime të cilat fuqimisht ndikojnë mbi stigmatizimin e bashkësisë rome në fushën e arsimit, si edhe në fusha të tjera. Në procesin e socializmit të fëmijës rom, i cili ndodhë fillimisht brenda familjes, barten informata për paraardhësit e tij, por edhe në numrin më të madh të rasteve, ai fëmijë rritet me prindërit dhe anëtarët e familjes më të ngushtë të cilët nuk posedojnë kurrfarë arsimi ose kanë një shkallë shumë të ulët të arsimit. Kjo ndikon mbi krijimin e imazhit tek fëmija për aspektet tradicionale të trajtimit të arsimit. Në moshën e tij shkollore, fëmija e krijon imazhin sa i përket arsimit edhe për familjet e tjera rome, përmes shokëve apo farefisit. Në kuadër të shkollës, shpeshherë ky fëmijë perceptohet nga fëmijët e tjerë, të cilët nuk janë pjesëtarë të bashkësisë rome, si jo të barabartë me ata dhe si të pa interesuar që ta ndjekin procesin arsimor. Në drejtim të rritjes së vet-perceptimit të dalimeve në krahasim me të tjerët nga njëra anë, dhe nga ana tjetër rritja e paragjykimeve midis fëmijëve të cilët nuk janë romë kontribuojnë mësimdhënësit. Shpeshherë, për shkak të njohurive më të ulëta të cilat i manifestojnë një pjesë e fëmijëve romë, njohja më e ulët e gjuhës maqedonase apo të udhëhequr nga paragjykimet e tyre të fituara e nxisin perceptimin ose vet-perceptimin për diversitetin sa i përket suksesit dhe interesimit për arsim. Kur një gjë e këtillë përsëritet me gjenerata e njëta kalon në botëkuptim tradicional dhe bëhet pjesë e një kulture të caktuar, si të bashkësisë etnike rome ashtu edhe të bashkësive etnike të tjera.

Supozohet se paragjykimet, sa u përket fëmijëve romë, konsistonë me atë se ata nuk kanë njohuri dhe shkathësi të mjaftueshme që ta fillojnë ose ta vazhdojnë arsimin në paralele të rregullta si fëmijë të cilët nuk janë kategorizuar dhe se një pjesë e madhe e prindërvë të fëmijëve romë nuk janë të interesuar që fëmijët e tyre të arsimohen. Bëhet fjalë për ekzistimin e paragjykimeve tek një pjesë e mësimdhënëse, pedagogëve, psikologëve ose tek një pjesë e shërbimeve profesionale të cilët janë të angazhuar për kategorizimin. Në këtë hulumtim nuk u vlerësuan qëndrimet ose stereotipat e

këtyre personave profesionistë, por nga bisedat me një pjesë të tyre ose përmes bisedave me përfaqësuesit e organizatave civile mund të konstatohet se është një nga faktorët i cili ndikon mbi ekzistimin e problemit të segregacionit por edhe bazë që të rekandohet tejkalimi i kësaj gjendje përmes ndërgjegjësimit të tyre.

Gjatë intervistave dhe fokus grupeve shpeshherë u theksua se njëri nga shkaktarët kryesorë të segregacionit janë prindërit e fëmijëve romë meqë, sipas mendimit të bashkëbiseduesve, ata e duan këtë që *të fitojnë asistencë për fëmijë me aftësi të kufizuara deri në moshën 26 vjeçare dhe me qëllim që më lehtë ta kalojnë arsimin fillor dhe të mesëm*. Pastaj, u theksua se ekziston një traditë e caktuar tek prindërit të cilët arsimin e tyre e kanë kaluar në shkolla të posaçme ose paralele të posaçme, kështu që i orientojnë edhe fëmijët e tyre në këtë lloj të arsimit të segreguar. Megjithatë, pavarësisht dëshirës së prindërvë, *institucionet duhet t'i shpërfillin kërkesat e pabaza të prindërvës*, *nëse ekzistojnë, meqë duhet të udhëhiqen nga parimi i interesit më të mirë të fëmijës* dhe se *ata janë përgjegjës për ardhmërinë e tyre me pranimin e kërkesës së pabazë të prindërvës*.

#### 3.2. SHKAQET PROCEDURALE PËR EKZISTIMIN E SEGREGACIONIT

##### 3.2.1. Niveli shkollor

Në bazë të dokumenteve zyrtare, intervistat dhe fokus grupet e realizuara, në përgjithësi mund të konstatohet se nuk ka procedura të qarta në procesin e kategorizimit. Madje, mund të konstatohet se gjatë fokus grupit të parë, një pjesë e pjesëmarrësve (të punësuar në shërbimet profesionale të shkollave ose mësimdhënës) nuk kanë njohuri të mjaftueshme sa u përket procedurave ekzistuese.

U konstatua se *përveç prindit, askush tjetër nuk mund ta iniciojë procedurën për kategorizimin e fëmijës*. Gjithashtu, në procedurën e përgjithshme nuk është përcaktuar roli i shërbimit profesional dhe mësimdhënësit të shkollës gjatë inicimit të procedurës ose gjatë zbatimit të saj. Nuk ka teste të standardizuara gjatë regjistrimit të fëmijëve në klasë të parë, përveç në nivelin e Qytetit të Shkupit, midis pedagogëve në kuadër të shoqatës së pedagogëve të Qytetit të Shkupit (sipas deklaratës të pedagogut pjesëmarrës në fokus grupin). U theksua nevoja e standardizimit në nivel shtetëror dhe u theksua mungesa e këshilltarit pedagog në Byronë për Zhvillimin e Arsimit me qëllim të vendosjes dhe koordinimit të harmonizimit të testeve dhe procedurës së testimit.

Gjatë arsimit fillor dhe të mesëm fëmijët, pjesëtarë bashkësisë rome nuk kanë mundësi të kenë mësim në gjuhën amtare (në gjuhën rome ose turke varësisht se në cilin rajon jetojnë përveç nëse gjuhë amtare nuk e kanë gjuhën maqedonase). *Gjuha paraqet pengesë edhe në procesin e testimit të fëmijës edhe gjatë procesit mësimor, mosnjohja ose njohja e pamjaftueshme*

e gjuhës, mund të paraqes bazë për fitimin e përshtypjes së gabueshme për zhvillimin psikik të fëmijës.

*Ekstrakt nga diskutimi në fokus grupin:*

A ka probleme me mosnjohjen e gjuhës?

“Testimi zhvillohet me ndihmën e mësuesit klasor. Në ekip çdoherë ka kolege e cila e njeh gjuhën rome që të mund të kuptohemi.”

Psikologu sugjeron se kur mësimdhënësit kanë problem me një fëmijë të caktuar gjatë procesit mësimor dhe do ta dërgojnë tek psikologu me argument se ai shpërfillt nga aspekti edukativ, shpeshherë konstatohet se ai fëmijë nuk i kupton meqë nuk e njeh gjuhën maqedonase. “Kur nuk jemi të sigurt se ndonjë fëmijë ka apo nuk ka aftësi të kufizuara e dërgojmë deri te Komisioni pranë Entit për Shëndet Mendor që ta jasin mendimin e tyre.”

Gjatë procesit mësimor mund të ndodhë të ketë nevojë që të testohet një fëmijë i caktuar, nëse vërehet se ka probleme të caktuara në zhvillim.

Ç'ndodhë me ata fëmijë, të cilët testohen në shkolla në të cilat askush nuk e njeh gjuhën e tyre amtare. Për shembull, në Maqedoninë Lindore, romët flasin në gjuhën turke?

“Atje testimi zhvillohet me vështirësi ndërsa gjatë procesit mësimor shpesh ndodhë që të pyetet ndonjë shok i tij rom që t'ia përkthejë. Shpeshherë pengesa të caktuara në zhvillimbulohen më vonë, gjatë klasës së parë ose të dytë, ndërsa më rrallë gjatë testimit. Kjo zbulohet gjatë procesit mësimor ose gjatë shoqërimit me shokët.”

“Thërriten prindërit e fëmijëve të cilët kanë problem me gjuhën maqedonase dhe u sugjerohet se ka nevojë që t'i përkushtojnë vëmendje më të madhe këtij problemi.”

“Gjuha rome është si lëndë fakultative”.

“Është shumë vështirë t'i përkushtohet vëmendje çdo fëmije i cili ka problem të këtillë, kjo gjë detektohet përmes shoqërimit me fëmijët e tjerë. megjithatë, në shkollën “Vëllezërit Ramiz” ka shembull pozitiv meqë numri më i madh i fëmijëve janë romë dhe ndihmohen mes tyre. Problem më i madh paraqitet aty ku numri i fëmijëve romë është më i vogël. Gjatë pushimeve mësimdhënësit përpiken vazhdimisht t'u flasin në gjuhën maqedonase.”

A e vendosni vet që fëmija të shkojë në Ent ose i sugjeroni prindit se ka nevojë ta çojnë fëmijën në vlerësim?

“Unë i thërras prindërit, të cilët rrallëherë manifestojnë rezistencë. Disa i dërgojnë ndërsa disa të tjerë akoma nuk i kanë dërguar. Kjo mbetet në vullnetin e prindërve.”

Duhet të theksohet se *nuk është rregulluar procedura për mbikëqyrje të vazhdueshme të zhvillimit psikik të fëmijës në kuadër të shkollës dhe procesit të iniciimit të rikategorizimit.* Një procedurë e këtillë nuk është rregulluar as në nivel shtetëror e as një nivel të shkollave dhe i është lënë praktikës tanimë të vendosur.

*3.2.2. Komisione për kategorizim*

Për kategorizimin, kompetent është Komisioni pranë Entit për Shëndet Mendor dhe komisionet të cilat funksionojnë në disa qytete të shtetit. Nuk janë mjaftueshmë të qarta kriteret në bazë të të cilave prindërit vendosin se a do ta dërgojnë fëmijën në kategorizim në Komisionin pranë Entit për Shëndet Mendor dhe në komisionet rajonale, dhe as që është mjaftueshmë i qartë dallimi sa u përket kompetencave të komisioneve në kuadër të komunave nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të Komisionit në Kuadër të Entit për Shëndet Mendor.

*Nuk ekzistonjë protokolle të shkruara sipas të cilëve bëhet vlerësimi i fëmijës dhe kategorizimi i tij.* Kjo bëhet në mënyrë multidisiplinore nga ekipi i përbërë nga psikiatri, psikologu, defektologu dhe punëtori social. Nga aspekti defektologjik dhe psikologjik, në bazë të intervistave të realizuara, u konstatua se mjedisi familjar dhe ai më i gjërë ndikojnë mbi zhvillimin psikik të fëmijës dhe arsimi i pamjaftueshmë dhe shkathësítë dhe shprehët e pamjaftueshme jetësore mund të kontribuojnë ndaj të ashtuquajturës prapambetje sociale tek fëmija e cila pasqyrohet mbi prapambetjen psikike tek fëmija. *Nga biseda gjatë intervistave dhe fokus grupeve u konstatua se nuk ka metodologji dhe procedura të zhvilluara për kufizimin e shpërfilljes së arsimimit dhe pengesave në zhvillimin psikik.*

*Ekstrakt nga diskutimi në fokus grupin:*

*Si bëhet kufizimi midis pengesës intelektuale dhe shpërfilljes së arsimimit?*

“Për shembull, fëmija nuk i di ngjyrat, nuk di të numërojë deri në dhjetë, i jepet test joverbal, mozaik i caktuar. Nga testimi i parë nuk dërgohet në Komision që të fitojë ndjenjë sigurie. Pas katër apo pesë takimesh dërgohen deri te Komisioni. Pyetjet janë të përgjithshme. Sa anëtarë keni në familje, çfarë bëni gjatë ditës? Si është koha jashtë dhe ngashëm. Edhe moskomunikimi me psikologun trajtohet si problem i cili paraqet indikacion.”

“Numri më i madh i tyre kanë qenë pacientë nga periudha e hershme e moshës së tyre. Kanë prapambetje bio, psiko dhe sociale dhe më së shpeshti dërgohen nga pediatri. Për pjesën më të madhe të tyre kemi hapur kartonë që në moshën tetëmbëdhjetë muajsh. Përqindja e fëmijëve të këtillë nuk dihet. Një numër i konsiderueshmë dërgohet nga shkollat e posaçme dhe të rregullta. Nuk është numri i vogël i fëmijëve të cilët dërgohen më vonë. Detyrimisht vijnë me udhëzim të mjekut amë.”

“Është më e pëlqyeshme triazha, megjithatë një gjë e tillë nuk praktikohet. Kjo do të thotë fillimisht të dërgohet deri te Komisioni që të kontrollohet në Ent.

Ajo bëhet në repartin e pranimit tek mjeku. Mjeku amë që të jetë i arsyeshëm cakton tek cilido qoftë në Ent dhe jo tek personi përkatës. Duhet që mjeku amë ta dërgojë jo në Ent por tek psikiatri pranë Entit. Dokumente të detyrueshme janë: udhëzimi nga mjeku amë; shkresë nga Qendra për Punë Sociale, meqë sido që të jetë rezultati nga ekzaminimi, i njëjtë duhet të regjistrohet në Qendër; sigurimi shëndetësor; ekstrakti nga Libri amzë i të lindurve për fëmijën dhe letërnjoftimi i prindit. Nuk është me rëndësi se a ka udhëzim nga shkolla.

“Prindi doemos duhet të deklarojë se pajtohet që të bëhet kategorizimi. Komisioni duhet të pranojë mendim nga triazha, megjithatë Komisioni e pranon edhe pa triazh.”

*Çka nënkuptohet me shpërfillje edukative dhe pengesë intelektuale? Si e identifikoni këtë linjë të dallimit? Pyetje për përfaqësuesin e Entit për Shëndet Mendor.*

“Nuk mundet të vendos një person. Shfrytëzojmë teste verbale dhe joverbale, për shembull nëse nuk e njeh gjuhën. Mund të ketë pengesa të lehta por të mos i takojë një kategorie të caktuar. Dallimi me shpërfilljen edukative, sa u përket fëmijëve me pengesa në zhvillimin psikik përfshin pengesa në aftësitë emocionale dhe intelektuale dhe ngjashëm. Aftësitë konjitive, sociale dhe emocionale janë shumë më të ndryshme në krahasim me fëmijët me shpërfillje edukative. Për këta fëmijë me shpërfillje edukative jepet konkluzion dhe jo diagnozë. Sapo të shihet se bëhet fjalë për konkluzion dihet se nuk bëhet fjalë për fëmijë me pengesa intelektuale.”

### 3.2.3. Evidenca për zhvillimin psikik të fëmijëve në periudhën parashkollore

Konstatohet se pediatrit nuk janë përshirë në procesin dhe as me veticinativë nuk mbajnë evidencë për zhvillimin psikik të fëmijës nga lindja deri në klasë të parë, ndërsa këtë evidencë shteti nuk e ka organizuar as përmes qendrave mjekësore në komuna të caktuara dhe as përmes aktivitetave të psikologëve dhe psikiatërve. Kjo është e nevojshme që të përcaktohet nëse tek fëmija janë konstatuar pengesa në zhvillimin psikik qysh në periudhën parashkollore, meqë sipas personave profesionistë, shumë më e madhe është mundësia se ndonjë fëmijë mund të kishte pengesa në zhvillimin psikik në periudhën shkollore nëse pengesa të këtilla ka pasur edhe në periudhën parashkollore.

Nëse mbahet një evidencë e këtillë do të ketë mundësi më të madhe që të bëhet një kufizim midis shpërfilljes të arsimimit dhe pengesave në zhvillimin psikik të cilat rezultojnë me pengesa intelektuale.

### 3.2.4. Transferimi nga shkolla e posaçme ose nga paralelja e posaçme në paralele të rregullt

Midis opinionit publik të defektologëve, psikologëve dhe pedagogëve është arritur konsensus rrëth nevojës së rikategorizimit të vazhdueshëm dhe juridikisht të standardizuar të fëmijëve të cilët janë kategorizuar me pengesa të lehta në zhvillimin psikik. Gjithashtu, ekziston konsensus rrëth nevojës nga i ashtuquajturi inkluzion, përkatësisht përfshirje të fëmijëve me pengesa të lehta në zhvillimin psikik në paralelet e rregullta. Ky proces do të kontribuojë në drejtim të integrimit më të madh të fëmijëve dhe do të ketë efekt më të madh mbi zhvillimin e tyre.

Paraprakisht u pasqyruan tendencat e përfshirjes së fëmijëve me kategorizim në paralelet e rregullta, megjithatë nevojitet të theksohet se *edhe përfshirja e fëmijës me kategorizim në paralelet e rregullta vetveti paraqet diskriminim*, meqë është një lloj i të ashtuquajturit semi-segregacion. Në shikim të parë, kjo është e përfshirë në paralelet e rregullta, megjithatë nëse merret parasysh se ai fëmijë do të mësojë sipas programeve të posaçme me cilësi të zvogëluar dhe me atë do të realizohet procesi mësimor i cili do ta përfshijë qasjen individuale, megjithatë kjo prapë se prapë nënkupton segregacion në kuadër të një paralele. Nëse me çdo fëmijë gjatë punës realizohet qasje individuale, atëherë qasja ndaj fëmijës së kategorizuar nuk do të jetë e ndryshme. **Nëse ndonjë fëmijë është kategorizuar pa bazë dhe procesin mësimor e zhvillon në paralele të rregullt ose është transferuar nga paralelja e posaçme në paralelen e rregullt edhe më tutje ai fëmijë në mënyrë të tërthortë është diskriminuar përmes të ashtuquajturit semi-segregacion ose segregacion latent në kuadër të një paraleleje.**

#### Ekstrakt nga diskutimi në fokus grupin:

Drejtoreshë e shkollës së posaçme

“Një numër i madh i fëmijëve dërgohen në shkolla të rregullta nga shkolla e posaçme, por pastaj prindërit kërkojnë të kthehen përsëri në shkollën e posaçme meqë nuk mund t'i përshtaten programit.”

“Në mënyrë masive dërgohen me shkresa. Nga ana e shkollave të rregullta. Ato arsyetohen se nuk janë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të fëmijëve.”

“Ka 20 fëmijë të cilët kanë problem të këtillë. Janë divergjent me planet mësimore. Fëmijët kanë kufizime edukative dhe sociale. Kanë problem me atë që nuk mund të përshtaten me mjedisin. Kanë probleme me transferimin e tyre nga shkolla e posaçme në shkollë të rregullt.”

“Kanë asistentë gjatë testimit ekstern, por një asistent të këtillë nuk kanë shkollat e rregullta.”

### *Profesor nga Instituti për Defektologji, Fakulteti Filozofik*

“Nëse bëhet një retrospektivë nga viti 1998, Instituti për Defektologji dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit realizuan projekt për inkluzion. Në këtë projekt u përfshin dy shkolla nga Manastiri meqë kanë numër të konsiderueshëm të fëmijëve të regjistruar romë. Projekti zgjati deri në vitin 2004. Problemi, sa i përket inkluzionit, është më evident për shkak të mosangazhimit të prindërve.”

“Regullorja nga viti 2000 e përfshin paradigmën mjekësore. Ne kemi diagnozë por nuk kemi vlerësim funksional. Është mirë që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përpilon Rregullore por Instituti për Defektologji nuk është konsultuar dhe duhet ta përfshijë paradigmën sociale.”

“Ne nuk kemi sistem për intervenime të hershme. Fëmijët duhet të evidentohen në repartet neonatalogjike, megjithatë nuk ekziston lidhja me institucionet parashkollore. Periudha zhvillimore është e rëndësishme dhe deri në moshën tetëvjeçare nuk duhet të kemi diagnozë, por vlerësim meqë sistemi neurologjik atëherë është më elastik.”

“Në Ligj nuk ka asnjë nen në të cilin përcaktohet mundësia e vlerësimit gjatë regjistrimit të fëmijës në shkollë. Pedagogu dhe psikologu nuk guxojnë të bëjnë vlerësim meqë kjo, nga ana tjetër, do të thotë edhe njëfarë lloji etiketimi madje do të reagojnë edhe prindërit. Në këtë mënyrë, regjistrohen fëmijë pa vlerësimin e potencialeve të tyre. Kërkjmë të përpilohet një plan individual arsimor, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nuk bëjmë vlerësim. Nuk kemi sistem të intervenimit të hershëm dhe të inkluzionit. Kohëve të fundit ka buxhet i cili financohet nga komunat, megjithatë nevojitet buxheti shtetëror. U dëshmua se në këtë mënyrë mjetet nuk arrijnë deri te fëmijët. Janë parashikuar katër qendra rajonale për vlerësim. Pa një zgjidhje sistemore, pa intervenim të hershëm në institucionet parashkollore nuk do të zgjidhet asgjë.”

“Në Manualin e vitit 2002 theksohet se duhet të përpilohet një Kodeks i praktikës inklusive, si dhe obligimet e prindërve dhe mësimdhënësve. Në fazën e katërt nevojitet Komisioni të bëjë vlerësim dhe të vendos për këtë tranzicion. Për fat të keq tani jemi në vitin 2014 dhe edhe sot e kësaj dite nuk kemi një praktikë të këtillë.”

### *3.2.5. Bashkëpunimindërinstitucional*

Konstatohet shkallë e ulët e bashkëpunimit ndërinstitucional edhe atë si midis organeve në nivel nacional, siç janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës por edhe midis autoriteteve të nivelit qendror dhe lokal, institacioneve nationale dhe shkollave në përgjithësi, institacioneve shtetërore dhe lokale me sektorin civil. Gjatë krijimit të politikës së përbashkët në drejtim të tejkalimit të këtij problemi inkurajon puna e përbashkët e institacioneve gjatë përpilimit të draft modelit për vlerësim.

Shkollat e posaçme dhe ato shkolla të cilat kanë punësuar defektologë nuk kanë zhvilluar procedura me të cilat do të mundësohet që të njëjtë të angazhohen nga shkollat e rregullta, në të cilat mësojnë fëmijë me pengesa të lehta në zhvillimin psikik.

Mungojnë politika të koordinuara për trajnime të të punësuarve dhe për prindërit në lidhje me pasojat negative të këtij fenomeni dhe për mekanizma parandalues nga i njëjtë. Mungan një sistem i zhvilluar i cili do ta mundësojë afrimin e njohurive dhe shkathtësive të fëmijëve romë nëse vlerësohet se kjo u nevojitet në raport me fëmijët e tjera, përmes aktiviteteve jashtëshkollorë ose përmes instalimit të vitit zero e që do të paraqes periudhë përgatitore. Sistemi i kopshteve për fëmijë është përjashtuar nga ky sistem i monitorimit në kontinuitet të zhvillimit të fëmijës gjë e cila apostrofohet si negative.

Disa pjesëmarrës në fokus grupet theksuan se njësitë e vetëqeverisjes lokale shpeshherë pasqyrojnë të dhëna joreale për numrin e fëmijëve me kategorizim, me qëllim që të fitojnë më shumë mjete nga shteti, meqë për këta fëmijë mjetet janë më të mëdha. Nuk është e qartë mënyra e financimit të shkollave, në të cilat mësojnë fëmijë të kategorizuar, dhe nuk dihet se sa nga mjetet të cilat akordohen nga shteti me të vërtetë u dedikohen fëmijëve, përkatësisht për nevojat e arsimit të tyre më cilësor apo ridedikohen për qëllime krejtësisht tjera.

**Ka tregues të cilët vënë në pah tendenca pozitive në tejkalimin e problemit.** Modeli i ri për vlerësim, të cilin e propozon Ministria e Punës dhe Politikës Sociale nuk është orientuar në drejtim të kategorizimit të fëmijës sipas pengesave të tij, por në drejtim të vlerësimit të aftësive të tij, përkatësisht është fokusuar mbi potencimin e aftësive të fëmijës dhe gjetjes së mënyrës së përshtatjes së kushteve me qëllim të përmirësimit të të njëjtave. Sa u përket aftësive të kufizuara, të njëjtave u qaset me të ashtuquajturin model social dhe jo me modelin mjekësor, përkatësisht nuk fokusohet vetëm mbi diagnozën por mbi gjendjen të cilën e ka fëmija dhe në drejtim të asaj se si të përmirësoset e njëjta. Thënë më saktë, si të krijohen kushte të cilat do t'i përshtaten gjendjes së fëmijës.

Gëzon fakti që iniciativë për vlerësim mund të ngre pediatri, ndërsa kjo nënkuption se bëhet fjalë për një mbikëqyrje permanente të zhvillimit të fëmijës dhe ripërkufizim të vlerësimit. Është përcaktuar edhe sistemi i nëntë qendrave/komisioneve rajonale që do të janë përgjegjëse për vlerësimin dhe një komision nacional, me çka pritet se dyshkallësia do të përforcohet por njëkohësisht edhe do të ketë kontroll më të madh dhe harmonizim gjatë punës. Megjithatë, u konstatua varshmëri nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale edhe pse përbërja duhet të jetë multidisiplinore ndërsa problematika është ndërsektoriale. Edhe pse planifikohet të zbatohet klasifikimi ndërkombëtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, megjithatë nuk është mjaft i qartë zbatimi i deritanishëm i tij në shtet dhe nuk është parashikuar një periudhë kalimtare për testimonin e të njëjtit.

Në mënyrë plotësuese, çdo lëndë do të shqyrtohet në Komision dhe do të udhëhiqet nga një anëtar i Komisionit, përkatësisht ai do të jetë përgjegjës për

